

VENDIM
Nr. 1, datë 20.1.2014

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN LEZHË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 20.1.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun e Lezhës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit, të znj. Mejreme Delishi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 61 prot., datë 17.1.2014, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Mejreme Delishi, deputete e zonës zgjedhore, qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës, dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 35, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Lezhë, në zgjedhjet për Kuvendin, të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore, qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Lezhës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Mimi Pjetër Kodheli, me numër rendor 2 (dy) Armando Ndue Prenga.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 852, datë 26.12.2013, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Mejreme Delishi, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Mimi Kodheli, deputete e zonës zgjedhore qarku Lezhë.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Lezhë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës, mandati i perkiste kandidatës znj. Mejreme Delishi, e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas zonjës Mejreme Delishi që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të depozituar nga PS-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të

zonës zgjedhore, qarku Lezhë, rezulton se kandidatja e radhës, sipas deklarimit është kandidatja me numër rendor 8 (tetë) znj. Mirela Zef Neli (Syku).

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 8 (tetë), znj. Mirela Zef Neli (Syku) të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore, qarku Lezhë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, znj. Mirela Zef Neli (Syku).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.